



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.888/ 4 Prot.

Tiranë, më 26. 06.2025

V E N D I M

Nr. 155, Datë 26. 06. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.140 Regj., datë 09.05.2025 të znj. M. M., përfaqësuar nga Av. M, D² kundër Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, në të cilën pretendon diskriminim pa përcaktuar ndonjë shkak.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankuesi parashtroi se: *Në cilësinë e avokatit për klienten time znj. M. M., përcjellim këtë ankesë ligjore drejtuar institucionit në lidhje me diskriminimin që i është bërë klientës time nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, Tiranë, duke shpjeguar si më poshtë:*

I ndjeri V. M., (ish-bashkëshorti i klientës time znj. M. M.) ka lidhur një kontratë ndërtimi apartamenti me shoqërinë “L.” sh.p.k në vitin 1996 në zonën Rruga “Siri Kodra” Tiranë pallat ky i cili ka përfunduar në të kohë dhe sot klientja ime nuk disponon certifikatën e pronësisë nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Sipas Prokurës së Posaçme nr. 976 rep., nr.203 kol., datë 25.07.2022.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Për sa sqaruar më sipër nga ana e Zyrës Ligjore të Avokat M. D., ku përfaqësohemi me anë të prokurës së posaçme me Nr. 976 Rep., dhe Nr., 203 Kol të datës 25.07.2022 të lëshuar (autorizuar) nga znj. M. M., kemi vijuar komunikimet shkresore-ligjore në emër të klientës time me Drejtorin Vendor të ASHK-së Tirana Veri Tiranë si vijon:

Kemi dërguar mbi 50 kërkesa dhe kujtesa ligjore Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë.

Në pallatin/apartamentin e klientës time para 1 viti nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë është paraqitur topografi i kësaj drejtorie për të bërë verifikimin dhe skicimin e apartamentit në fjalë.

I kemi vendosur në dispozicion kësaj drejtorie nga topograf privat të licensuar plan rilevimi të detajuar dhe ia kemi përcjellur kësaj drejtorie. I kemi vendosur në dispozicion kësaj drejtorie:

- *Kontratën për ndërtimin e apartamentit të datës 19.09.1996. (e noterizuar)*
- *Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore dt 18.03.2022. (e noterizuar)*
- *Çertifikatë personale e datës 27.03.2025 (për znj. M. M.) (origjinale)*
- *Çertifikatë personale e datës 27.03.2025 (për znj. S. M.) (origjinale)*
- *Çertifikatë personale e datës 27.03.2025 (për z. P. M.) (origjinale)*
- *Çertifikatë familjare e datës 27.03.2025 (për z. P. M. dhe znj. S. M.)*
- *Çertifikatë familjare e datës 27.03.2025 (për znj. M. M.) (origjinale)*

Nga komunikimet shkresore që Zyra Ligjore e Av. M. D. ka pasur me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë ka prej vitit 2022 e deri më sot komunikime pa fund nga ana jonë me objekt specifik duke kërkuar “Vendimmarrjen e Legalizimit të Apartamentit” ndodhur në Rrugën “Siri Kodra” Tiranë sipas “Kontratës së Ndërtimit të Apartamentit” të datës 19.09.1996 të lidhur me shoqërinë “L.” shpk (shiko shkresat e avokatit me dërgim postar dhe datat e dërgimit)

Nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë na kanë ardhur vetëm 3 shkresa:

- *Shkresa me Nr 5335/1 Prot të datës 27.08.2024 ku na citohet se duhet të nënshkruhet kontrata përfundimtare e shitjes.*
- *Shkresa me Nr 5335/5 Prot të datës 17.09.2024 ku na citohet se duhet të nënshkruhet kontrata përfundimtare e shitjes.*
- *Shkresa me Nr 5335/8 Prot të datës 18.10.2024 ku na citohet se ndiqen procedurat e ligjit 20/2020.*

Në çdo shkresë që Zyra Ligjore e Av. M. D., i ka dërguar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë i është shpjeguar në mënyrë të përsëritur disa herë se Shoqëria e Ndërtimit “L.” nuk lidh kontratë shitje përfundimtare me klienten tonë të cilën e përfaqësojmë pasi kjo shoqëri ndërtimore ka konflikte/mosmarrëveshje me disa prona të truallit e për pasojë e ka braktisur klienten time për t’u zotuar për lidhur/nënshkruar një kontratë të tillë ndaj dhe i jemi drejtuar

Drejtoria Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë prej afro 5 vitesh komunikime me këtë institucion shtetëror.

Punonjës të Drejtoria Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë të cilët trajtojnë rastin me ashpërsi të drejtpërdrejtë dhe direkte nuk kanë vullnet ligjor për t'i dhënë zgjidhje dhe në asnjë kohë dhe moment nuk kanë marrë një vendim të drejtë ligjor për të vendosur Vendimmarrjen e Legalizimit të Apartamentit të ndodhur në Rrugën "Siri Kodra" Tiranë sipas Kontratës së Ndërtimit të Apartamentit të datës 19.09.1996 të lidhur me shoqërinë "L." sh.p.k.

Nga Drejtoria Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë po punohet jo sipas ligjit por me dy standarde të kundërligjshme duke theksuar si më poshtë:

Nga njëra anë në emër të klientës kemi plotësuar çdo kusht dhe kriter ligjor ndodhur në atë çfarë kemi shpjeguar më sipër e për pasojë kjo drejtori nuk ka lëshuar ende një Vendimmarrje të Legalizimit të Apartamentit të ndodhur në Rrugën "Siri Kodra" Tiranë sipas Kontratës së Ndërtimit të Apartamentit të datës 19.09.1996 të lidhur me shoqërinë "Lura" shpk.

Nga ana tjetër ka mbi gjysmën e banorëve të apartamenteve që e kanë certifikatën e pronësisë konkretisht sjellim si provë materiale një me nr pasurie 4/186/ND+1-12 të ZK 8360 të ndodhur në një nga katet e pallatit ku ka apartamentin edhe klientja ime.

Për të dyja pikat e mësipërme për sa shpjeguar më lart kemi të bëjmë jo vetëm me dy standarde të kundërligjshme por edhe me një diskriminim të pastër që institucioni publik që ofron shërbimin që është nga Drejtoria Vendore të ASHK-së Tirana Veri Tiranë po shkakton dëme në vonesa dhe mosdhënien e të drejtës klientës time kjo e bazuar edhe në Ligjin Nr 10 221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (ndryshuar me Ligjin Nr 124/2020) të ndryshuar.

Për sa shpjeguar më sipër, bazuar në prova shkresore nga ana jonë, bazuar në legjislacionin në fuqi, konkretisht: Ligji Nr. 111/2018 "Për Kadastrën"; Ligji Nr. 20/2020 "Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 55/2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" të ndryshuar, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Veri, Tiranë, akoma nuk ka dhënë zgjidhjen ligjore që duhet të merrte – "Vendimmarrjen e Legalizimit të Apartamentit të ndodhur në Rrugën "Siri Kodra", Tiranë, sipas "Kontratës së Ndërtimit të Apartamentit' të datës 19.09.1996, të lidhur me shoqërinë "L." sh.p.k., që më pas ky dokument të regjistrohej brenda 1 muaji në ASHK për lëshim certifikate, kartelet dhe harte pronësie.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, marrjen e masave disiplinore dhe ndëshkuese, përfshirë gjobë administrative, ndaj Drejtoria Vendore të ASHK-së Tirana Veri, për mosveprim, zvarritje dhe shkelje të detyrimeve ligjore dhe zgjidhjen e problematikës.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankuesit me shkresën nr.888/1 prot., datë 10.06.2025, ku kërkohet informacioni i mëposhtëm:

- Të sqarohet qartë se cilat janë shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Ky informacion duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, i cili vërteton se ju i mbartni këto shkaqe.
- Të shpjegohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju e konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen shkakësore midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës suaj.

Sa sipër, nga ana e palës ankuese nuk u kthye asnjë përgjigje dhe nuk është plotësuar informacioni që u kërkua nga ana e Komisionerit me shkresën nr.888/1 prot., datë 10.06.2025 dhe pse sipas Ftetës së Lajmërim- Marrjes nr. RR783433536AA të Zyrës Postare, e ka marrë këtë shkresë që në datën 11.06.2025.

III. Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim

objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur nënen 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. *Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Ankuesja znj. M. M., përfaqësuar nga avokati i saj, ka paraqitur një ankesë për diskriminim institucional ndaj Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, lidhur me refuzimin dhe zvarritjen e pajustificuar për lëshimin e vendimarrjes së legalizimit për një apartament në Rrugën “Siri Kodra”, Tiranë, të ndërtuar nga shoqëria “L.” sh.p.k., mbi bazën e një kontrate të lidhur në vitin 1996. Pala ankuese pretendon se pavarësisht plotësimit të të gjitha dokumenteve ligjore, përfshirë kontrata të noterizuara, çertifikata dhe planimetrinë përkatëse, dhe megjithëse janë depozituar shumë shkresa dhe kërkesa për legalizim, institucioni kanë refuzuar të ndërmarri vendimin përfundimtar për legalizim, duke shkaktuar dëme të vazhdueshme ligjore dhe administrative ndaj ankuses.

Referuar ankesës dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion me këtë ankesë, rezulton se ASHK Tirana Veri ka reaguar me vetëm tre shkresa formale në të cilat është përsëritur që duhet të nënshkruhet kontrata përfundimtare e shitjes një veprim që është bërë i pamundur për klienten për shkak të mosveprimit të shoqërisë ndërtuese “L.”, sh.p.k., e cila nuk është në gjendje të lidhë kontratë përfundimtare për shkak të konflikteve me pronarët e truallit. Sipas subjektit ankues Drejtoria ka injoruar këtë fakt ligjor të njohur dhe ka aplikuar standarde të dyfishta, pasi një pjesë tjetër e banorëve të pallatit ka përfituar çertifikata pronësie, ndërsa ankuesja jo. Kjo përbën, sipas pretendimit të palës ankuese, një trajtim diskriminues dhe të kundërligjshëm, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe aktet e tjera përkatëse.

Pas verifikimit të ankesës dhe dokumenteve bashkëlidhur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) konstatoi se ankesa kishte nevojë për plotësim dhe, me shkresën nr. 888/1 prot., datë 10.06.2025, i kërkoi pales ankuese të sqarojë shkaqet e pretenduara të diskriminimit sipas nenit 1 të Ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar. Gjithashtu

të tregojë ndikimin konkret të këtyre shkaqeve në trajtimin e konsideruar diskriminues, si dhe të dorëzojë çdo informacion apo dokumentacion shtesë që mbështet pretendimin. Megjithatë, sipas fletës së njoftimit të Zyrës Postare (nr. RR783433536AA), pala ankuese e ka marrë shkresën më datë 11.06.2025, ajo nuk ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk ka plotësuar informacionin e kërkuar nga Komisioneri, duke lënë pa adresuar kërkesat thelbësore për vijimin e shqyrtimit të ankesës.

Nga ana e pales ankuese nuk është depozituar asnjë dokumentacion ligjor apo provë konkrete që të vërtetojë që mbart ndonjë shkak në kuptim të nenit 1 të Ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar. Po ashtu, pala ankuese nuk ka sqaruar në asnjë moment nëse ka ndonjë shkak konkret apo si ky shkak i pretenduar për diskriminim kanë ndikuar konkretisht në situatën e saj dhe cilat janë pasojat që i kanë ardhur si rezultat i kësaj gjendjeje. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur lidhjen ndërmjet rrethanave të paraqitura dhe trajtimit të pretenduar diskriminues.

Në aspektin procedural, fillimisht pala ankuese duhet të provojë se disponon një shkak të mbrojtur nga ligji dhe se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është pikërisht ky shkak. Nëse arrihet ky nivel provueshmërie, atëherë barra e provës për të vërtetuar të kundërtën pra, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i kalon palës tjetër.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të paraqeste fakte dhe prova që mbështesi pretendimin e saj për diskriminim. Në këtë rast, pala ankuese nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e saj për diskriminim.

Vetëm pasi pala ankuese të paraqesë fakte dhe prova të mjaftueshme, barra e provës kalon tek pala e paditur, e cila duhet të provojë se veprimet e saj nuk përbëjnë diskriminim. Kjo është një detyrim ligjor i palës tjetër, që duhet të vërtetojë se trajtimi i ankuesit nuk ka qenë diskriminues, duke ofruar prova dhe argumente që mbështesin legjitimitetin e veprimeve të saj.

Si konkluzion nga analiza ligjore e ankesës rezulton se pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete apo dokumentacion që të vërtetojë ekzistencën e një shkakut të mbrojtur sipas nenit 1 të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe as ka sqaruar lidhjen shkakësore ndërmjet këtij shkakut dhe trajtimit të pretenduar diskriminues nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Veri. Mungesa e këtyre elementeve e bën të pamundur ngritjen e një dyshimi të arsyeshëm për diskriminim dhe rrjedhimisht, nuk përmbushet pragu i nevojshëm për kalimin e barrës së provës tek pala e paditur.

Në përfundim, duhet theksuar se provave dhe fakteve konkrete janë të domosdoshme për vijimin e shqyrtimit të ankesës dhe, në mungesë të tyre, Komisioneri nuk mund të konstatojë elementë të mjaftueshëm për të vazhduar me hetimin administrativ të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në

përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër ASHK Tirana Veri, nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur hetimin dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 20, pika 1, germa “a”, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. M. M., përfaqësuar nga Av. M. D.⁴ kundër Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁴ Sipas Prokurës së Posaçme nr. 976 rep., nr.203 kol., datë 25.07.2022.